



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 7 prot.

Kamëz, më 26 / 1 .2026

V E N D I M

Nr. 7 .Datë 26 / 1 2026

MBI

**“NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 89, DATË 17.12.2025
PËR: “SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAT VENDORE NË BASHKINË KAMËZ”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 26.1.2026, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.06 Datë 23.1.2026 mbështetur në gërmën “f”, të nenit 54, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; VKM-në nr. 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”...”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjin nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin 82/2025 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 107, datë 31.07.2014, “Për planifikimin e territorit” i ndryshuar; VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar; Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, i ndryshuar; Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit, i ndryshuar: **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit dhe shtesën të vendimi nr. 89 datë 17.12.2025 si më poshtë;

Në kapitulin A.5 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”, në pikën 3, shkronja (a) ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

a) Për ndërtimet që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të ndërtimeve individuale për qëllime përdorimi vetjak nga individët, të ndërtuar nga vetë individi apo me sipërmarrës taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 3% të vlerës së investimit.

2. Pas shkronjës a) shtohet shkronja (a.1) me përmbajtje si më poshtë:



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

- a.1) Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e industrisë për qëllime publike dhe ndërtimet e tjera për qëllime publike, që do të ndërtohen nga organet publike dhe shtetërore, në nivel qendror, entet publike si dhe shoqëritë aksionere me aksioner shtetëror taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 1% të vlerës së investimit.
3. Në kapitulin A.5 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”, tek shënimet shtohet shënimi si më poshtë:
Përfshihen nga pagesa e kësaj takse objektet pronë e paluajtshme e shtetit dhe të destinuara për ushtrimin e funksioneve publike, me pronësi publike, të ndërtuara me financime nga buxheti i shtetit, njësitë e vetëqeverisjes vendore apo nga investimet e enteve publike.
4. Ngarkohen Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimit e Zhvillimit Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë**.

**KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI**

